



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivered	15. 03	2023	3	viti god year
Organ / Rjesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIMSHOK	2673	2023	15	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.142/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.142/2023 të datës 06.10.2022 të parashtruar nga ankuesi. të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati, me adresë: Rruga "Fehmi Agani", Hyrja 154, Kati i I, Numër 8, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.03.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.142/2023 e datës 06.10.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Vendimi me numër të protokollit 4262/4 i datës 29.12.2022 i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe çështja kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* të organi i njëjtë.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi, \_\_\_\_\_, i punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 24.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 748/2023 e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.142/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 4262/4 të datës 29.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit dhe shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, pasi që nuk ka marr përgjigje përmes vendimit në shqetësimin e ngritur lidhur me konfliktin e interesit që ka njëri nga anëtarët e komisionit respektivisht anëtar \_\_\_\_\_ sikurse ankuesit nuk i është dhënë mundësi në seancë që të paraqesë argumentet apo provat kundër shkeljeve të pretenduara, inicimi i procedurës disiplinore nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material pasi që i njëjti ka qenë nën presion të Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sikurse masa e shqiptuar disiplinore nuk është mbështetur me prova dhe fakte relevante.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 03.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuesit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa me datën 01.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 748/2023 të datës 24.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit Disiplinor me numër 4262/4 e datës 29.12.2022; Inicimi i procedurës disiplinore me numër 4262 i datës 01.12.2022; Akt emërimi me numër 462 datës 20.02.2013; Autorizimi i datës 21.12.2022; Kopja e letërnjoftimit; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 30.12.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 17.01.2023; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 30.11.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ e datës 21.11.2022; Vendim i lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm me numër 08/2 e datës 17.01.2023; Vendim për zgjedhjen e Komisionit Disiplinor me numër 4056 e datës 13.10.2020; E-mail i dërguar nga MBPZHR drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 29.12.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ datës 20.01.2023; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar H.S e datës 23.01.2023; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 28.12.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 10.11.2022; E-mail dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 14.02.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 23.02.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ datës 21.09.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 04.08.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ datës 29.09.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 04.10.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ e datës 13.05.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ datës 12.09.2022; Vendimin i përkohshëm për punë shtesë i datës 29.08.2022; E-mail i dërguar nga \_\_\_\_\_ drejtuar \_\_\_\_\_ datës 31.08.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë



e datës 03.02.2023; Përgjigja në ankesë e datës 01.03.2023; Shpalljen e Konkursit me numër ref.12 IBK- Pejë e datës 20.02.2010; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore me numër 4660 e datës 18.11.2020; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 10.11.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 21.09.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar datës 13.12.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 29.11.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 23.02.2023; Ekstrakt i procesverbalit me numër 774 e datës 25.02.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 906 e datës 03.03.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 1473 e datës 08.04.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2019 e datës 27.05.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 3972 e datës 10.11.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2085 e datës 02.06.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2964 e datës 02.09.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 2000 e datës 25.05.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 3972 e datës 10.11.2022; Ekstrakt i procesverbalit me numër 525 e datës 10.02.2022; E-mail i dërgua nga T.A drejtuar e datës 22.12.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar dhe e datës 23.12.2022; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 12.12.2022; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 22.12.2022; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 23.12.2022; Procesverbal i takimit të komisionit disiplinor i datës 28.12.2022; Ndryshim plotësimi i akt emërimit me numër 2043 i datës 06.07.2015; Akt emërim me numër 1841 i datës 11.05.2016; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit me numër 2209/8 i datës 12.07.2019; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 23.01.2023; Deklaratë e datës 28.02.2023; Deklaratë e datës 28.02.2023; Deklaratë e datës 28.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe se çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë-Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 05.01.2015 është i punësuar në pozitën e punës "Drejtor i Institutit Bujqësor të Kosovës- Pejë" pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa pas kërkesës së Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zëvendës Sekretari i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 01.12.2022 kishte iniciuar procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mos përmbushjes së detyrave të punës; shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; kryerja e përsëritur brenda dhe jashtë orarit zyrtar të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi si dhe shkelja e detyrave të përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes Vendimit me numër të protokollit 4262/4 të datës 29.12.2022 kishte konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të përcaktuara me nenin 45 paragrafi 1 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.6, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, paragrafi 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë si dhe nenit 5 paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores (QRK) – Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim i ngritjes

*në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen e shkallës së pagës për një periudhë nga dy deri në pesë vjetë përkatësisht në periudhë pesë (5) vite”.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor se njeri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor ka qenë në konflikti të interesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nenin 10 paragrafi 5 nën paragrafi 5.3 dhe neni 6 ku përcaktohet se: *“5. Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesi paraqitet ndërkohë ata zëvendësohen nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Institucionit për raste si në vijim: 5.3 Kur kryesuesi apo anëtari i komisionit me shkelësin e dyshuar bie në kundërshtim me dispozitat e LPPA-së, për rastet e përjashtimit nga procedura; 6. Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative”*, andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në provat e lëndës Kolegji i Këshillit vlerëson së e-maili i datës 23.01.2023 dhe deklaratat e datës 28.02.2023 të anëtarëve të Komisionit Disiplinor lidhur me kërkesën e ankuesit së anëtari i Komisionit Disiplinor me inicialet . ka konflikt interesi në këtë procedurë, nuk plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 29 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase nga shkresat e lëndës me asnjë provë nuk mund të vërtetohet së Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar kërkesën e palës ankuese lidhur me faktin nëse janë plotësuar kushtet për përjashtimin e ndonjërit nga anëtarët e Komisionit Disiplinor nga procedura administrative, kështu që mbi këtë bazë rezulton së pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar. Ndërlidhur me këtë konstatim, Komisioni Disiplinor në procedurë të rishqyrtimit të lëndës duhet të shqyrtoj kërkesën e palës ankuese jashtë seancës procedurale nëse anëtari . apo ndonjëri nga anëtarët e tjerë të Komisionit Disiplinor ka konflikt interesi në këtë procedurë dhe nëse ka bazë ligjore për përjashtim e tyre nga procedura administrative.

Po ashtu në kuptim të nenit 48 ndërlidhur me nenit 47 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar Vendimin e kundërshtuar me ankesë sipas dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar së i njëjti nuk përmbush elementet e detyrueshme të aktit administrativ ndërlidhur me arsyetimin, sepse përmbajtja e aktit të kontestuar është e paqartë, dhe vendi nuk përben shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; rrjedhimisht Komisioni Disiplinor në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar së ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore duke ju referuar e-mailave korrespondues pa zbërthyer përmbajtjen e tyre të komunikimeve veç e veç, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret..”* andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ është akt i paligjshëm.

Po ashtu, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, arsyetimi i vendimit të goditur me ankesë nuk është në pajtim me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse në vlerësimin e Kolegjit elementet e përgjegjesisë disiplinore të përcaktuar me këtë dispozitë ligjore duhet të vlerësohen në mënyrë komulative në mënyrë që të konstatohet ekzistimi i veprimit të paligjshëm apo mosveprimit, ndodhja e pasojës/dëmit; dhe lidhja shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.

Prandaj, bazuar si me sipër dhe duke qenë se vendimi me numër të protokollit 4262/4 i datës 29.12.2022 i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është i përfshirë me shkelje procedurale, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit dhe lënda të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje në mënyrë që Komisioni Disiplinor t'i eliminojë shkeljet e gjetura sipas këtij vendimi si dhe të marrë parasysh pikëpamjet juridike të Kolegjit.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.142/2023**

**Flakron GASHI**

  
Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të palës ankuese,
- Kryetarit të Ministrisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së.